

Fustani duhet të jetë i përshtatshëm dhe i denjë për eventin ku ai do të vishet. Ja disa këshilla se si mund të zgjidhni veshjen e duhur për të dalë në kafe, restorant, vizitë te miqtë dhe takim apo event zyrtar.



Në bar dhe kafe

Nëse po shkon në një kafe moderne, plot njerëz, me gatime jo të zakonshme dhe me kokteile nga më të çuditshmet, atëherë ti mund të eksperimentosh me veshjen tënde.

Këtij vendi do ti përshtateshin një këmishë me ngjyrë të çelët mëndafshi me fund apo pantallona të errëta dhe me këpucë me takë (apo çizme kur bëhet fjalë për sezonin e vjeshtës apo të dimrit). Kjo veshje do tju tregonte tepër elegante dhe njëkohësisht trendy dhe me stil.

Nëse do të shkosh në një kafe të tillë në mbrëmje dhe do të jesh me disa miq, atëherë një fustan kokteili (me disa ngjyra dhe elemente të kombinuara me njëra-tjetrën) do të ishte ideale dhe ti do të bije në sy.

Nëse po përgatitesh të shkosh në një klub, pub ose disko, atëherë jepi liri fantazisë tënde. Në këtë rast vlen vetëm një këshillë - veshja të jetë e hapur, provokuese, trendy dhe të nxjerrë në pah pjesët më të bukura të linjave tuaja dhe sigurisht, më e rëndësishmja, që ti të ndihesh sa më mirë dhe komode.

Si shembuj të varianteve ideale mund të përmendim: një fustan mëndafshi ngjyrë koral të nderur, një fustan të ngushtë me ngjyra të arta të leopardit apo çdo fustan tjetër me ngjyrat në modë të stinës dhe që ju rrijnë mirë pas trupit.



Në restorant

Nëse planifikon të shkosh në restorant për një darkë romantike me partnerin, nuk duhet eksperimentuar shumë me ngjyrat dhe aksesoret dhe duhet zgjedhur çdo gjë me më tepër kujdes.

Në raste të tilla më mirë të vishesh më serioze dhe elegante, por sigurisht që veshja juaj nuk duhet ti ngjajë veshjes së zyrës. Për pranverën dhe vjeshtën është shumë e përshtashme një fund dhe këmishë, të kombinuara me këpucët elegante me takë dhe me një xhaketë të lehtë.

Për tu dukur më tepër elegante dhe femërore, mund të zgjedhësh një fund me bel të lartë, që është edhe hit i sezonit dhe ti përshtatësh këpucët apo sandalet e duhura.

Fustani - është absolutisht një variant ideal për një darkë në restorant. Por ki kujdes për çdo detaj, fustani nuk duhet të jetë i ngarkuar dhe me shumë ngjyra dhe mos e tepro me aksesoret.



Për vizitë tek miqtë

Nëse planifikon të shkosh për një vizitë të shkurtër apo për darkë tek miqtë, atëherë relaksohu pasi sështë e nevojshme të ndjekësh rregullat e veshjes si në një mbrëmje.

Por kjo nuk do të thotë se mund të dalësh me rrobat sportive të shtëpisë! Pasi, megjithëse miqtë mezi presin të të takojnë, është e kuptueshme që atyre do tju pëlqente më shumë nëse ju visheni bukur dhe ikushtoni rëndësi kësaj pjese edhe për takimin me ta.

Mëndafshi dhe pëlhurat me material të derdhur do ti jepnin karakter festiv veshjes tuaj. Prandaj, mund të veshësh xhinse, fund apo pantallona të thjeshta të kombinuara me një bluzë, këmishë apo kanatjere prej mëndafshi apo atllasi dhe do të dukesh shkëlqyeshëm.

Një menyrë tjetër për tu veshur thjesht por festive në raste të tilla është edhe përdorimi i aksesoreve apo veshjeve ngjyrë ari ose argjendi me efekt dhe shkëlqim metalik.



Takim zyrtar

Nëse të kanë ftuar në një mbrëmje apo eveniment zyrtar, ku ka një dres-kod të caktuar, atëherë duhet të bësh shumë kujdes me zgjedhjen e veshjes.

Përveç veshjes, çdo gjë tjetër në këtë rast duhet ti përshtatet mbrëmjes, që nga modeli i flokëve deri tek këpucët dhe aksesorët, që duhet të jenë zyrtarë, elegantë por edhe festivë (nëse bëhet fjalë për evenimente të tilla si jubilar apo inagurim).

Një veshje universale për këtë rast është një fustan i vogël i zi, i cili duhet të jetë i pranishëm sigurisht, në garderoën e çdo femre.